



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1271/ 3 prot

Datë 16.06.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekti:** Skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medi -Tel” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-24972-04-13-2022 me objekt “Evadimi i mbetjeve spitalore”, me fond limit 8,862,945.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.05.2022 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal “Memorial” Fier.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK
Pasuria nr. 1070, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali Rajonal “Memorial” Fier
Qender, Afrimi i Ri, Rruga “Daullas Grecalli” Nr 17, Daullas, Fier
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK
Durres, L.3, Rruga Egnatia/3, Godina 1039, Zona Kadastrale Nr.8514, Volumi 38, Faqe 125, Numri i Pasurisë 4/162-N

Në datën 15.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2022/2281 dhe me nr. 1271/2022 prot., datë 15.06.2022 e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” SHPK. Gjithashtu operatori ekonomik ankimues të njëjtën ankesë e ka paraqitur edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1271/1 prot., datë 15.06.2022.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kërkesën për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK duke shtuar edhe arsye të tjera skualifikimi përveç atyre të përcaktuara nga autoriteti kontraktor për

skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi-Tel” SHPK për të cilat është publikuar nga KPP formulari i publikimit me nr. 1095/2, datë 23.05.2022.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Eco Riciklim” SHPK me anë të ankesë me numër ankimi elektronik A/2022/2281 datë 15.06.2022 dhe me nr. 1271/2022 prot., datë 15.06.2022, si dhe përmes ankesës së dorëzuar në KPP me nr.1271/1 prot., datë 15.06.2022 pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Medi-Tel” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Medi-Tel” SHPK përveç kriterëve të cilat kanë qenë arsye skualifikimi nga autoriteti kontraktor dhe që janë publikuar nga KPP në formularin e publikimit me nr. 1095/2, datë 23.05.2022 **edhe kriteret si më poshtë vijon:**

- **Kriteri 3.3.5:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e depozitimit të dokumentave të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

- **Kriteri 3.3.7:** Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera impiantet për trajtimin me sterilizim dhe asgjësimin me incenerim të seciles kategori të prokuruar nga A.K të mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të VKM-se Nr. 798, datë 29.09.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm.

Ne rast të përdorimit të kontenierëve njëpërdorimsh, të paraqitet një vetëdeklarim në të cilin të deklarohet se: kontenieret që ofrohen nga OE, janë brenda standarteve ligjore të kerkuara në fushën e mbetjeve të rezikshme spitalore.

Per të vertetuar përmbushjen e këtij kriteri OE, duhet të paraqesë:

-Dokumentacionin për vertetimin e pronësive ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

-Impiantet për trajtimin me sterilizim dhe asgjësimin me incenerim, njëkohësisht makineria për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisore III.1.C

dhe/ose III.1.B ose të jenë pasqyruar në Lejet Mjedisore të paraqitura në përmbushje të kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 më sipër;

-Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;

-Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.06.2022

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri